

VENDIM
Nr. 79, datë 10.2.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT ABU DHABI
PËR ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “NDËRTIMI I BULEVARDIT
VERIOR DHE REHABILITIMI I LUMIT TË TIRANËS”, RATIFIKUAR ME
LIGJIN NR. 150/2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së huas, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Abu Dhabi për Zhvillim, për financimin e projektit “Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr. 150/2013, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Logoja

Datë: 24.12.2020

Ref.: ADFD/DGO/2020/1311

Sh.S.znj. Anila Denaj,
Ministre
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Republika e Shqipërisë

Lënda: *Zgjatja e datës së mbylljes – Projekti “Bulevardi Verior i Tiranës dhe Rehabilitimi” – huaja nr. 1193*

Shkëlqesia Juaj,

Ju dërgojmë përshëndetjet më të mira nga Fondi për Zhvillim i Abu Dhabit (ADFD).

I referohemi Marrëveshjes së Huas, të nënshkruar më datë 21.4.2013, ndërmjet Fondit për Zhvillim të Abu Dhabit dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, për financimin e Projektit “Bulevardi Verior i Tiranës dhe Rehabilitimi”, dhe shkresës suaj me nr. ref. 15723/8, të datës 2.12.2020, në lidhje me kërkesën për të zgjatur të drejtën e tërheqjes mbi projektin e lartpërmendur.

Dëshirojmë t’iu informojmë se Fondi ka kënaqësinë të pranojë kërkesën tuaj për zgjatjen e tërheqjes, të datës **30 dhjetor 2020**, e cila është në përputhje me Marrëveshjen e Huas, neni III, seksioni 9.

Ju lutem, pranoni sigurinë e konsideratës sime më të lartë.

Me respekt,

/nënshkrimi/

Khalifa Abdulla Al Qubaisi
Zëvendësdrejtör i përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 15723 / Prot.

Tiranë, më 2 / 12 / 2020

Lënda: Projekti "Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës"

FONDIT ABU DHABI PËR ZHVILLIM
P.O. Box: 814, Abu Dhabi
Emiratet e Bashkuara Arabe

Të nderuar,

I referohem marrëveshjes së Huasë të datës 21 prill 2013, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Abu Dhabi për Zhvillim, për financimin e projektit "Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës". Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve të parashikuara për t'u financuar nga kjo marrëveshje dhe në përputhje me sa kërkuar nga Bashkia Tiranë, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- Shtyrjen e afatit të tërheqjes së fondeve deri më 30 dhjetor 2020, Neni 3, pika 9;

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë nënshkruar më 21 prill 2013, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Abu Dhabi për Zhvillim, për financimin e projektit "Ndërtimi i bulevardit verior dhe rehabilitimi i Lumit të Tiranës"

Ky ndryshim hyn në fuqi, pasi palët të njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme.

Me respekt



MINISTËR

Anila Denaj

nbir", Nr. 3, Tiranë, Shqipëri;

Web: www.financa.gov.al